



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:257931

Datë: 18.04.2024

Numri i dokumentit: 05591638

AC-I-22-0687

Në ankesën e

Paditësi/Ankuesi

NTP L Prishtinë, (pronar S H), adresa B e E, Prishtinë.

kundër

E paditura

NSH "Dardania" Prishtinë (në likuidim) e përfaqësuar nga, **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, Rr. "Dritan Hoxha", nr.55, Lakërishtë, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani gjyqtar kryesues, Shkelzen Sylaj dhe, Ilmi Bajrami gjyqtarë, duke vendosur sipas ankesës së paditësit të paraqitur kundër Aktgjykimit të shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-13-3270 të datës 05 dhjetor 2022, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 18 prill 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- 1. Ankesa e paditësit refuzohet si e pa bazuar.**
- 2. Vërtetohet Aktgjykimi i Shkallës së I-rë i DHPGJS-së, C-IV-13-3270 i datës 05 dhjetor 2022.**
- 3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.**

Rrethanat procedurale dhe faktike

Me 22 nëntor 2013, paditësi, ka parashtruar në DHPGJS një ankesë kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit (AL) PRN105-0165, të datës 31 tetor 2013, me të cilin ishte refuzuar kërkesa e tij për kompensimin për dëme të luftës në shumë prej 42,000.00 euro (qofte se kompensimi monetar nuk është në dispozicion atëherë parashtruesi i kërkesës kërkon kompensimin në formën e seteve ose në ndonjë formë tjetër të kompensimit) lidhur me NSH "Dardania" në Prishtinë. Paditësi pohoi se me vendimet e veta AL ka refuzuar kërkesën e qiramarrësit NTP "L", për kompensimin e dëmit të shkaktuar nga qiradhënësi NSH "Dardania" të shkaktuar gjatë luftës në Kosovë në vitin 1999 në depon e materialit ndërtimor dhe produkteve bujqësore e cila gjendet në pronën e të paditurit në Obiliq, pasi që gjatë luftës 25 mars -13 qershor 1999, është vjedh dhe demoluar malli dhe pajisjet tjera, pasi që rojet e të paditurit nuk i kanë kryer detyrat e veta të punës për ruajtjen e mallit dhe pajisjeve dhe nga kjo i është shkaktuar dëm ankuesit i cili është provuar me procesverbalin në shumë prej 81.574,00 DM e nënshkruar nga KFOR dhe UNMIKU si institucione të vetme të sigurisë se asaj kohe. Ka shtuar se i pa kënaqur me vendimet e AL ka parashtruar ankesë në aftin ligjor për shkak të interpretimit jo adekuat të kontratës dhe ankesave të saj, vendimet me arsyetime absurde. Paditësi pretendimet e tij i paraqet mbi bazën e kontratës së datës 26 shkurt 1997 dhe tre ankesë kontratave të datës 14.03 dhe 17.12.1997 dhe 01.02.1999 dhe deklaratave të dy dëshmitarëve-rojeve të depon të datës 19.07.1999, me propozim që të abrogohen vendimet e atakuar dhe të merr vendim për kompensim të dëmit të NTP"L" të shkaktuar nga NSH"Dardania" si dhe kamatën bankare dhe fitimin e humbur dhe vuajtjet psikike e shëndetësorë të shkaktuara për këtë rast. Më mbështetje të ankesës ka dorëzuar dëshmitë në kopje si: Vendimet e kundërshtuara, kontratat e datës 26.02.1997, aneksi 14.03.1997, aneksi i datës 17.12.1997, aneksi i datës 01.02.1999 dhe deklarata e të dy rojeve procesverbali dhe specifikimi i dëmit i datës 21 dhe 29 qershor 1999, kërkesa për kompensim të dëmit Komisionit për dëme të

luftës në Obiliq date 19.07.1999, kërkesa dorëzuar Komisionit për vlerësimin e dëmeve të luftës- Qeverisë së Kosovës dhe foto të bëra nga Depo date 03.06.1999.

Me 05 shtator 2018, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS mbrojtjen në ankesë. Në mbrojtje në ankesë AKP-ja i kundërshtoi pretendimet ankimore të paditësit duke i konsideruar si të pa bazuara në ligj. AKP-ja pohon se paditësi duhet të dorëzoi prova nga të cilat mund të vërtetohen fakte të rëndësishme ngase prej konstatimit të drejtë dhe të ligjshëm të tyre varet edhe vendimmarrja. Agjencia mbështet vendimet e AL të NSH" dardania" duke e konsideruar si të drejtë dhe të ligjshëm dhe e beshtet vendimin e AL të NSH" Dardania" Duke e konsideruar si të drejtës dhe të ligjshëm në baze të nenit 36.2 të Shtojcës së Ligjit NR.04/L034 për AKP kur kërkesa apo pretendimi është drejtuar tek organi jo kompetent dhe është i pas afatshem sipas kufizimeve kohore të aplikueshme, si dhe në baze të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar i cili thekson se çdo kompensim parashkruhet për 10 vite, andaj e paditura i propozoi gjykatës që ankesa të hedhet poshtë ose të refuzohet si e pa bazuar në ligj dhe vërtetohet vendimi i kundërshtuar.

Me 28 shtator 2018, paditësi e dorëzon edhe një parashtresë në DHPGJS dhe përgjigjet në mbrojtjen e AKP-së me të cilën i kundërshton në tersi pretendimet e palës në mbrojtje duke i konsideruar të hamendësuar, pa mbështetje faktike dhe juridikë për rrethanat e verimeve të ndodhura, duke mos i referuar asnjë prove materiale dhe si të tillë e konsiderojmë ligjërish të pa bazuar, si dhe ka përsëritur pretendimet paraqitura në ankesë, me kërkesë që gjykata të hedhë poshtë mbrojtjen në padi të AKP dhe të marr vendim për të kompensuar paditësi demin.

Më 09 tetor 2018, e paditura parashtroi kundërpërgjigje me të cilën mbetet në tersi pranë mbrojtjes dhe fakteve të theksuara me rastin e kundërshtimit të ankesës, me propozimin që gjykata ta refuzojë ankesën në tersi si të pa bazuar.

Me 05 dhjetor 2022, Shkalla e I-rë e DHPGJS-së me Aktgjykimin C-IV-13-3270 e refuzon ankesën e paditësit si të pabazuar dhe e vërteton vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit PRN105-0165, datë 31 tetor 2013 si të drejtë dhe të bazuar në ligj. Shkalla e I-rë e DHPGJS-së ka arsyetuar se paditësi nuk ka ofruar asnjë dëshmi relevante që dëshmon ekzistencën e paraqitjes së kërkesës për kompensimin e dëmit dhe se nuk ka dëshmi që kërkesën e tillë të ketë parashtruar para Autoritetit kompetent apo që kërkesën e tillë të ketë paraqitur në ndonjë gjykate nga marsi 1999- deri në janar 2004, kur të njëjtën kërkesë e ka parashtruar tek Agjencia Kosovare e Mirëbesimit, andaj gjykata gjen se AL drejt ka vendosur kur e ka refuzuar kërkesën e parashtruesit, në zbatim të nenit 36.2.1 të Shtojcës së Ligjit nr.04/L034 për AKP që parashikon: *"elementet në vijim përbejnë baze të mire dhe të mjaftueshme sipas këtij ligji për refuzimin e një kërkesë apo interesi të pretenduar të kapitalit apo pronësisë.....kërkesa apo pretendimi është i pas afateshme sipas kufizimeve kohore të aplikueshme"*. Në pajtim me nenin 376.1 të Ligjit për marrëdhëniet e Detyrimeve (të publikuar në Gazetën zyrtare RSFJ nr.29-1978), kërkesa i nënshtrohet periudhës së parashkrimit prej tre vitesh.

Shkala e I-rë ka konstatuar se në këtë çështje juridikë nuk ka gjetur ndonjë pretendim të paditësit në përputhje me dispozitat ligjore për të miratuar ankesën e tij të parashtruar kundër vendimit të AL. Pra, në këtë kuptim, paditësi ka dështuar që të parashtronte prova në mbështetje të kërkesës së tij edhe pas pranimit të mbrojtjes së të paditurës. Shkalla e I-rë kishte konstatuar se në mungesë të dëshmive pretendimet e paditësit lidhur me të drejtën e tij në kompensim për dëme të pësuar nga e paditura, nuk janë të mbështetura me provat e nevojshme materiale, prandaj si të tilla janë refuzuar si të pa bazuara.

Me 22 dhjetor 2022, paditësi (në tekstin e mëtejme ankuesi) ka dorëzuar në DHPGJS një ankesë të afatshme kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së C-IV-13-3270 të datës 05 dhjetor 2022, për të gjitha bazat

ankimore dhe kërkon nga Kolegji i Apelit që të aprovohet ankesa si e bazuar, dhe që Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme që propozuesit në emër të kompensimit të dëmit ti kompensojë shumën e mallit të vjedhur, shkatërruar dhe demoluar së bashku me kamatën e aplikueshme për periudhën e shkuar, kompensim edhe të dëmit psikik dhe mental për gjithë kohën e kaluar të pritjes. Padiësi e ka kundërshtuar aktgjykimin e ankimuar për shkak se mundësia e ruajtjes së mallit nga rojet e objektit të cilët kanë qenë punëtorë të ish qiradhënësit NTP D" Prishtinë- të cilët e kanë deklaruar këtë me shkrim. Verifikimin e gjendjes nga institucionet ekzistuese të kohës të themeluar nga Organi i kombeve të Bashkuara me seli në NEW York sikurse ishte: institucioni qeverisës komunal në Obiliq i themeluar nga UNMIKU(II) segmentin e sigurisë KFOR në Obiliq dhe Prishtinë, (iii) Komisioni Qeveritare dhe shumë takime me ish stafin e AKM-së. Refuzimi i menaxhemntit të NTP "D" me u marrë me shqyrtimin e ankesës, mospranimin e padisë sime për dëmin e shkaktuar nga ish NTP " D" në Gjykatën komunale të Prishtinës, me arsyetimin se nuk janë kompetente për të vendosur në këtë çështja juridikë, gjë që ka qenë e çuditshme nga gjykata të dëgjohej për këtë etj. ka shtuar se ish NTP" D" nuk ka marrë në shqyrtim kërkesë për kompensimin e dëmit, e vetmja mundësi ka mbete të proceduar e ankimit të udhëhiqet për realizimin e se drejtës sonë tek organi i likuidimit të ndërmarrjes si strukture organizative e AKM-së. Njoftimet e pranuar nga AKM-ja të datave 18 nëntor 2010 dhe 21 shkurt 2021 me të cilat informohemi se ka filluar procesi i likuidimit të ish NTPD" Prishtinë për parashtrim të kërkesës të cilin veprim e kam përmbush me kohë dhe në aftin ligjor të përcaktuar nga autoriteti i likuidimit të AKM-së.

Më 20 dhjetor 2023, AKP-ja ka pashtuar përgjigje ndaj ankesës së parashtruar nga padiës, me të cilën ka propozuar që te refuzohet ankesa si e pa bazuar dhe të vërtetohet aktgjykimi i shkallës së I-rë. AKP-j anë përgjigjen e parashtruar ka theksuar se lidhur me argumentet e ankesës është qartësisht dhe mjaftueshmerisht i sqaruar në mbrojtjen e parashtruar si dhe në Aktgjykimin me nr C-IV.-13-3270 pranë DHPGJS-së. Përsëritja e

atyre argumenteve të cilat janë parashtruar më parë do të ishin të pa dobishme për mbarëvajtjen e procedurës, për këtë arsye pala kundërshtare i parashtron Kolegjit të Apelit që ti referohet mbrojtjes dhe aktgjykimin përkatës.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa e paditësit refuzohet si e pa bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj duhet të vërtetohet.

Kolegji i Apeli vëren se paditësi me 22 dhjetor 2010 kishte parashtruar kërkesë tek Agjencia Kosovare e privatizimit, me të cilën ka kërkuar kompensim për dëme të luftës në shumë prej, 42,000.00 Euro, por që AL kishte refuzuar kërkesën e paditësit si të përshkruar konform nenit 376.1 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (të publikuar në Gazetën zyrtare RSFJ nr.29-1978). Për me tepër AL në vendimin e saj kishte arsyetuar se paditësi kishte dorëzuar, bashkëlidhur me formën e kërkesës Marrëveshjen e huazimit të Magazinës, nr.01/97, i datës 25 shkurt 1997, të nënshkrua mes parashtruesit (si huamarrës) dhe NSH“ Gazimestan”(emri i mëhershëm i NSH Dardania) (si Huadhënës). Parashtruesi, në pajtim me këtë marrëveshje, kishte kërkuar kompensim për humbje të materialeve në magazinë, gjatë periudhës së konfliktit të armatosur në Kosovë 1999). Ky Autoritet i Likuidimit ka konstatuar se në pajtim me marrëveshjen e përmendur, NSH nuk ka pasur ndonjë obligim nga parashtruesit në lidhje me sigurinë e hapësirave.

Shkalla e I-rë e DHPGJS me Aktgjykimin e ankimuar e ka refuzuar ankesën e paditësit si të pabazuar dhe ka vërtetuar vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit PRN105-0165, datë 31 tetor 2013 si të drejte dhe të bazuar në ligj.

Kolegji i Apelit pajtohet me konstatimet e Shkallës së I-rë të DHPGJS e cila ka arsyetuar se paditësi nuk ka ofruar asnjë dëshmi relevante që dëshmon ekzistencën e paraqitjes së kërkesës për kompensimin e dëmit dhe se nuk ka dëshmi që kërkesën e tillë të ketë parashtruar para Autoritetit kompetent apo që kërkesën e tillë të ketë paraqitur në ndonjë gjykatë nga marsi 1999-deri në janar 2004, kur të njëjtën kërkesë e ka parashtruar tek Agjencia Kosovare e Mirëbesimit.

Kolegji i Apelit gjithashtu vlerëson se Shkalla e I –rë, drejtë ka vendosur kur e ka refuzuar kërkesën e paditësit dhe ka vërtetuar vendimin e AL, pasi që neni 36.2.1 të Shtojcës së Ligjit nr.04/L034 për AKP që parashikon që *"elementet në vijim përbejnë baze të mire dhe të mjaftueshme sipas këtij ligji për refuzimin e një kërkesë apo interesi të pretenduar të kapitalit apo pronësisë.....kërkesa apo pretendimi është i pas afateshme sipas kufizimeve kohore të aplikueshme"*. Neni 376.1 të Ligjit për marrëdhëniet e Detyrimeve (të publikuar në Gazetën zyrtare RSFJ nr.29-1978), kërkesa i nënshtrohet periudhës së parashkrimit prej tre vitesh.

Kolegji i Apelit vlerëson se paditësi me padinë e tij të dorëzuar në Shkallën e I-rë dhe me ankesën në Shkallën e II-të nuk dorëzon asnjë dëshmi apo kërkesë që ka parashtruar para ndonjë Gjykatë apo organi tjetër kompetent nga Marsi 1999 kohën e ngjarjes) deri 16 Janar 2004. Andaj në bazë të nenit 376.1 të ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (publikuar në Gazetën Zyrtare RSFJ Br.29/1978), kërkesa i nënshtrohet periudhës së kufizimeve prej tre viteve. Në pajtim me dispozitën e mësipërme, kërkesa skadon tri vite pas ndodhjes së humbjes, që është tri vite nga marsi 1999, periudha kur u shkaktua dëmi i pretenduar, andaj paditësi/ ankuesi nuk ka dorëzuar asnjë dëshmi ne mbështetje të perëndimeve të tij përveç që pretendon se ka të drejtën në kompensim për dëme të luftës në shumë prej, 42,000. euro.

Kolegji i Apelit i ka shqyrtuara dhe vlerësuar pretendimet ankimore, mirëpo nuk ka gjetura se ka shkelje, prandaj nuk mund të pajtohet me pretendimet e paditësit, pasi që të njëjtat nuk janë të argumentuara dhe nuk janë të mbështetura në Ligj.

Bazuar në këtë gjendje faktike Shkalla e I-rë e DHPGJS me të drejtë me Aktgjykimin e ankimuar e ka refuzuar ankesën e paditësit si të pa bazuar dhe e ka vërtetuar vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit.

Andaj nga këto arsyeje, ankesa e paditësit është refuzuar si e pa bazuar dhe është vërtetuar Aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në Ligj.

Me sa u tha më sipër e në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, është vendosur si në dispozitiv.

Taksat gjyqësore

Ankuesi tashmë e ka paguar taksën gjyqësore për procedurën ankimore, në shumë prej 100 euro, me datë 24 janar 2023, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 18 prill 2024.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar Kryesues
